



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-41026 dt. 24.08.2021

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 31.08.2021 (e martë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.07.2021.
2. Buxheti i Komunës së Drenasit sipas kufijve dhe qarkores buxhetore 2022/02 për vitet 2022-2024
3. Propozim vendim i komisionit për emërtim të rrugëve.
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
5. Diskutim i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
6. Diskutim i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020.
7. Propozim vendim për ridestitim të mjeteve.
8. Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.
9. Propozim vendim për shqyrtimin publik i ndryshimeve të projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.
10. Të ndryshme.

Drenas, 24.08.2021

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë: 24.08.2021, si vijon:

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca për rendin e ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- propozoi edhe tri pika shtesë për rendin e ditës: 1.

- 1. Propozim vendim për ridestitim të mjeteve.**
- 2. Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.**
- 3. Propozim vendim për shqyrtimin publik i ndryshimeve të projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.**

Pasi që nuk pati diskutime tjera, verejtje apo sugjerime, kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës ku votuan me këto tri pika shtesë të cekura më lartë me:

06 vota për, 00 kunder dhe 00 Abstenim.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 23.07.2021.

Nuk pati diskutime verejtje apo sugjerime dhe votuan në mënyrë unanime, të gjithë anëtarët e KPF-së.

2. Buxheti i Komunës së Drenasit sipas kufijve dhe qarkores 2022/02 për vitet 2022-2024

Pasi që nuk pati diskutime tjera, verejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend.

3. Propozim vendim i komisionit për emërtim të rrugëve.

Meqë nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend.

4. Raporti i punës Janar-Qershor 2021 i kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.

Nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime.

5. Diskutim i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Meqë nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend.

6. Diskutim i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020.

Meqë nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend.

7. Propozim vendim për ridestitim të mjeteve.

Pasi që nuk pati diskutime, verejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend me:

07 vota për, 00 abstenim, 00 kunder.

8. Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend me:

7 vota për, 00 abstenim, 00 kunder.

9. Propozim vendim për shqyrtimin publik i ndryshimeve të projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime këtë pikë të rendit të ditës e rekomanduan për kuvend.

10 Të ndryshme.

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10:50

Drenas, 24.08.2021


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-37361 dt. 10.08. 2021

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
30.07.2021**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 30.07.2021

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 29.06.2021.
2. Informim i kuvendit për aktivitetet e KKSB-së.
3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021.
4. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.
5. Propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve.
6. Të ndryshme.



Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 30.07.2021 ishin: Kryesuesi Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari i Komunës Arben Shala, drejtorët e drejtorive komunale, shefi i kabinetit të kryetarit Flamur Curri.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoj të hapura punimet për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, ku prezantoi me rendin e ditës:

Petrit Gashi, propozoi që propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve të tërhiqet sepse me marrjen e informatës që do të del kjo në kuvend kanë ardh edhe kërkesa të reja duam t'i shqyrtojmë edhe ato në mënyrë që e mos të lëmë hapësirë me pastaj me pas probleme tjera lidhur me këtë proces, jemi në përfundim të procesit mirëpo për arsye të kërkesave të reja duhet me i trajtu edhe ato.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime tjera hodhi në votim rendin e ditës me propozimin e Petrit Gashit që pika e 5 propozim vendim i komisionit për emërim të rrugëve të largohet nga rendi i ditës. Prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, për votuan 25 anëtar, kundër 00, 1 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 29.06.2021.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, për votuan 26, kundër 00, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për piken e dytë të rendit të ditës: **2. Informim i kuvendit për aktivitetet e KKS-së.**

Nënkryetari i Komunës Arben Shala- me udhëzim administrativ me të cilën rregullohen këshilla për fshatra, KKS-jë detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të KKS-së pika 1.8 është i obliguar që të behet informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet të KKS-së. Ju njoftojmë se gjatë kësaj periudhe deri sot që po raportojmë janë mbajtur 3 takime me dt. 5 shkurt, 14 prill dhe 29 qershor 2021, në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me siguri e bashkësi në Komunën e Drenasit, siguria fizike, siguria e ambientit, siguria shëndetësore, rrugore etj, ne mbledhje janë ftuar anëtarët e KKS-së monitorues ku sipas afatit ligjor 7 dite para mbledhjes janë dërguar ftesa me rendin e ditës. Pikat përfshijnë ato që u ceken me lartësi dhe mbajtjen e mësimit online gjatë pandemisë, problemet e mësimit online etj. Tek të ndryshmet përvesë pikave të rëndësishme është diskutuar edhe siguria në trafik përkatësisht angazhimi i stacionit policor në Drenas për siguri në trafik, për këto mbledhje janë mbajtur procesverbale nga koordinatori i KKS-së, janë ete publikuara e në ueb faqen e Komunës së Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të ditës: **3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021.**

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, në zëvendësim të drejtorit të financave dha disa sqarime, po e sqaroi në pika të shkurta raportin financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Qershor 2021, ju njoftoj se ky raport është i bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike duke respektuar standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Është i ndarë në pesë kategori, ato funksionale me 20 programe dhe nënprograme. Buxheti i parapare për këtë vit është 15,399,334,00 €,

Vehbi Berisha, tek tabela tek të hyrat vetanake nuk kemi arrit me kap shifrën 90 % të planifikimit të realizimit tek të hyrat vetanake por fatmirësisht siç shihet nga qershori e tejkalon këtë plan dhe besoj që do t'ju afrohet shumës së 90 % edhe pas nuk e ka arrit, natyrisht drejtorisë së ekonomisë ju takon studime me të thella me shiku pse kemi pas rënies, mirëpo pandemia nuk është faktor që ka ndikuar pothuajse kaloi ky vit fatmirësisht nuk ka qenë edhe shumë i varur nga pandemia, ajo çka me bëri përshtypje nga viti në vit është nga drejtoria e infrastrukturës ka një zhvillim shumë të vogël vetëm 8% sepse pjesa kryesore po realizohet pjesën e dytë të vitit dhe po mbetëm mbrapa, a mundemi me arrit se paku 90 % e realizimit të buxhetit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, të hyrat vetanake nuk kanë arrit 100% jo 90 % për arsye, e kemi fal takson e operimit edhe nuk është në nivelin e pritshëm, sa i përket investimeve kapitale dhe shpenzimeve këtë afat deri në këtë fazë 8 %, ne mund t'i bëjmë pagesa kompanive që i fitojnë tenderët, mundemi me i pagu para kohe por e kërkojnë 10% apo 15 % por ata nëse nuk kërkojnë ne nuk mund të bëjmë pagesa pa i zhvillu punimet dhe pa u bërë pozicionet të cilat mund të paguhet, ju e dini që edhe për shkak të pandemisë kemi pas vonim të zhvillimit të tenderave sepse ka qenë pandemia dhe nuk na kanë lejuar me u zhvillu tenderët, 35 punishte i kemi në Drenas duke u zhvilluar përvesë atyre që i kemi kthyer

ne zero punimet jashtë standardit dhe po i dëmtojnë qytetaret, ne do te marrim masa për çdo njërin që nuk i bënë punimet si duhet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, për votuan 26, kundër 00, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për piken e katërt të rendit të ditës: **4. Bartja e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave.**

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, i njoftoj në pika te shkurta me këtë propozim vendim për bartjen e mjeteve nga Rezerva Buxhetore për projektin digjitalizimi i shkollave, ju njoftoj ashtu siq e keni edhe materialin e bashkangjitur ky projekt ka qene i planifikuar edhe vitin e kaluar por e kemi marrë edhe aprovimin e asamblesë komunale si projekt i ri mirëpo është hy në rezervë buxhetore mirëpo për me mujt me e zhvillu këtë projekt na duhet edhe një herë aprovimi juaj, ky projekt përfshin digjitalizimin e shkollave ku ne digjitalizim shohim platformën për digjitalizim dhe rrjetin e brendshëm infrastrukturën teknike shkollore për digjitalizim, ju ftoj ta mbështetni.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, për votuan 26, kundër 00, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për piken e pestë të rendit të ditës: **Të ndryshme.**

Sokol Bylykbashi, pasi përshëndeti të gjithë fillimisht foli për qendrën e mjekësisë familjare ne fshatin Terstenik ku janë duke u zhvilluar punimet, para disa dite isha aty dhe me thanë që dy muaj nuk janë zhvilluar punimet nuk e dina arsye pse, dhe një kërkesë tjetër nga stafi ku është e domosdoshme ku inventarin me e fut të vjetrin, inventari shumë i vjetër i ndryshkur, nuk kisha pas dëshirë me punu stafi në objekt te ri me inventar të vjetër. Kërkesa tjetër është ku kanë ankuar edhe banoret e fshatit Llapushnik për djeponin ilegale, problemi është që edhe po i djegin mbeturinat ku edhe e ndotin ajarin është mire me reagu me e pastru dhe besoj qe edhe qytetaret kane me u vetëdijesu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, foli për zjarre vënien e qëllimshme në deponi inerte në Llapushnik, dhe mbeturinat tjera të cilat nuk janë të lejuara dhe nuk janë të parapara më u hedh në atë deponi, me ligj obligohen me mbikëqyr dhe me marrë masa, gjitha veprimet i kam ndërmerre, do të dalin incizimet që njerëzit shkojnë e hedhin mbeturinat dhe i ndezin ato dhe i bëjnë këto veprime të kundërligjshme, dhe ne kemi marrë masa.

Sokol Bylykbashi, sa i përket deponive dhe problemeve me ambientin hedhjes së mbeturinave sa herë flasim për këto deponi ne gjithmonë duhet ti kemi parasysh se kemi të bëjmë me një pa ndërgjeshmëri të qytetareve se dikush i hedh ato mbeturina, dhe nuk akuzohet gjithmonë vetëm komuna, normal që edhe komuna duhet të përfundoj punën e vet, është mirë që të gjitha ato foto edhe video qe po i argumenton kryetari me i bërë publike dhe me u merr organet kompetente me ata njerëz të pa përgjegjshëm.

Petrit Gashi, përshëndetje nëse bane edhe një pyetje kryetar pasi jemi të kjo pjesë në bazë të vendimit 2014 është plotësimi i hendekut aty për me e mbush me mbeturin të fort inertë dhe besoi që ajo ka përfundua a ka mundësi largimi i asaj depoje mbyllja e saj tash e tutje .

Drejtoresha e Shërbimeve Publike Lumnije Krapit, sa i përket vendimit që është publiku në ëeb faqe d.m.th ai vendim nuk ekziston se ne 2014 ai vendim është marr prej Kuvendit pa dal në terën është shumë afër banorëve të Mulakt dhe me vlerësimin e ndikimit në mjedis 250 duhet me qenë larg shtëpive mirëpo, me qene se në rregulloren për menaxhimin e mbeturinave është e nevojshme përcaktimi i një deponie inerte atëherë ne si komune kemi shkuar dhe kemi marrë në shfrytëzim prej pjesë AKP-së ,ndoshta jeni të informuar që para shtatë -tetë vite kanë vdekur dy fëmije të mitur dhe kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi dashtë me i mbulua ato gropa për me ju shmang rrezikshmërisë dhe që të mos përsëritet e njëjta fatkeqësi në momentin që plotësohet ajo gropë, ne i largojmë rrethojat dhe i vendosim në një vend tjetër .

Nexhmedin Balaj, faleminderit drejtoresh për arsyet ,mua po me intereson sa janë marr masat në atë vend ku janë ato deponi të mbeturinave shumë mirë e cekë, në vitin 2012 edhe unë kam qenë pjesë e kuvendit në atë kohë kur e kemi marr atë vendim nuk e kemi pas këtë informatë ndoshta është dashur me ditë ne si asamblistë që mos me jepe atë leje mirëpo po me intereson a janë ndërmarr masa ndonjëherë në atë kohë prej kuvendit komunal se si kanë ardhur deri të këto gropa ,sepse është bërë një gërryerje e egër e dheut aty gjatë ndërtimit të autostradës ,por dua ta di a ka leje prej kuvendit që ju kanë dhanë operatore për me i qel ato gropa ,sepse ato gropa janë 200 metra afër njëra tjetrës dhe populli e din kush ka marr zall kush ka marr dhe , dhe ka përfitua prej atyre gropave .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, pyetje me vend ne jemi duke bashkëpunuar me komisionin e pavarur për miniera minerale jo vetëm me i identifikua por edhe me marrë masa ndaj çdo keq bërësi si ndajë atij ne Golesh . Nuk e dimë a kanë pas leje por kanë pas pëlqime disa herë .

Sabrije Kukaj, pasi qenka 250 metra mos me pas deponi inerte atëherë a i shihni deponitë e tjera që po i prishin shtëpitë e po i vendosin në mes te lagjes një rrebesh i shiut me ra neve po na dëmton se po i vendosin afër lumin materiale te shtëpive te prishura .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, e kam përsërit disa herë që unë i kam marr të gjitha veprimet ndaj inspektoriatit .

Vehbi Berisha, deshta me e ngrit një çështje meqenëse me pëlqej shumë mënyra e fakteve dhe e argumentimit me foto dhe video të asaj deponie ,nëse kishe mundur me e bërë të njëjtën gjë edhe te lagja Bunjaku që ndahet prej rrugës kryesore e që shkon kah përmendorja sepse ne vazhdimësi ka njerëz të pandërgjegjshëm që hedhin mbetura të dimë dhe te identifikojmë se kush është ,nuk po them që nuk ka punuar komuna se e ka pastruar dy tri here dhe ka vendos shenja që mos gjuani mbeturina por e kot.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, të gjithë ata persona keqbërës që bëjnë këto veprime të nivelit të ulët do të bëjmë të pamundurën qe ata të përballen me organet kompetente .

Sabrije Kukaj, janë dy rrugë të shtruara me kocka para vitit të ri dhe kompania që i ka punuar këto rrugë ende rërën nuk i ka vendose se di a është pranuar ai projekt a jo ,dhe shtrati

i lumit që nuk është pastruar ende deri kur duhet me prit në fshatin Verboc se ai ka gënjyer për livadhe se aty nuk e pengon askush sepse ai i ka prish arat ,banoret aty asgjë nuk kanë mundur me bërë në atë pjesën rreth lumit .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, do të shohim se çfarë mundemi me bërë dhe çdo projekt do te përfundojmë në mënyrën me të mirë të mundshme .

Sokol Bylykbashi, ne po i shohim ato punime që po bëhen edhe me ujësjellës edhe me kanalizim , të gjitha punimet që bëhen skajit të rrugës ,po unë mendoj që në rrugë është dashur me i mbyll ato gropa, e pastaj punimet që bëhen në anësorë të rrugëve nuk është problem sepse në gjithë botën kryhen punë të tilla .

Mbledhja përfundoj rreth orës 11:12 min

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi

Fakete Hoti

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA GLOGOC

GLOGOC MUNICIPALITY

Pranuar

17/08

2024

Nj. Org.

Numër

Shënjica

Vlera

01-

400-

39182

TABELAT E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITET 2022-2024

Viti 2022							
Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithësej:	
Z.Kryetarit	156,956	48,985		7,000		212,941	
D.Administratës	234,863	131,700			30,000	396,563	
D.Inspeksionit	73,584	40,215				113,799	
Z.Kuvendit	109,380	46,950				156,330	
D.Buxhet-Financa	103,190	18,000				121,190	
D.Sh.Publike	163,309	292,269	145,008	90,000	247,600	938,185	
D.Infrastrukturës	49,510	25,879			2,640,128	2,715,517	
Z.Kom.Kthim	7,956	530				8,486	
D.Bujqësi, Pylltari	75,813	12,327		50,000		138,140	
D.Zhv.Ekono.	48,741	23,600		23,000		95,341	
D.Gj.K,Pronë	83,731	11,078			400,000	494,809	
D.Urbanizem	47,798	18,417			40,000	106,215	
Adm.Shëndetësi	36,381	52,340		25,000		113,721	
QKMF-ja	1,297,624	414,134	54,000		322,856	2,088,614	
QPS-ja	91,503	16,713	5,951			114,167	
D.K,R,Sport	74,920	89,949		125,000	245,000	534,869	
Adm.Arsim	76,755	228,513		100,000	402,000	807,268	
Ars.Para-Fillor	119,979	46,482	6,549			173,010	
Ars.Fillor	4,556,872	434,176	65,000			5,056,048	
Ars.Mesem	1,291,135	147,743	22000			1,460,878	
R.përmbledhës	8,700,000	2,100,000	298,508	420,000	4,327,584	15,846,091	
	8,700,000	2,100,000	298,508	420,000	4,327,583	15,846,091	

Viti 2023

Viti 2023

Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komu nale	Subvencion e	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Z.Kryetarit	157,741	48,985		8,000		214,726
D.Administratës	236,037	130,700			10,000	376,737
D.Inspeksionit	73,952	39,515				113,467
Z.Kuvendit	109,927	45,450				155,377
D.Buxhet-Financa	103,706	18,500				122,206
D.Sh.Publike	164,126	292,839	133,239	120,000	248,523	958,727
D.Infrastrukturës	49,758	26,008			3,317,767	3,393,533
Z.Kom.Komun.	7,996	540				8,536
D.Bujqësi,Pylltari	76,192	12,329		47,155		135,676
D.Zhv.Ekonomik	48,985	27,100		25,000		101,085
D.Gj,K,Pronë,	84,150	11,078			400,000	495,228
D.Urbanizem	48,037	18,417			40,000	106,454
Adm.Shëndetësi	36,563	53,340		30000		119,903
QKMF-ja	1,304,112	462,502	73,905		348,726	2,189,245
QPS-ja	91,961	16,713	5,952			114,626
D.K,R,Sport	75,295	89,949		125,000	172,000	462,244
Adm.Arsim	77,139	247,410		100,000	141,884	566,433
Ars.Para-Fillor	120,579	46,482	6,120			173,181
Ars.Fillor	4,579,656	434,176	65,000		267,111	5,345,943
Ars.Mesem	1,297,591	147,743	22,000			1,467,334
R.përmbledhës	8,743,500	2,169,776	306,216	455,155	4,946,011	16,620,658
Finale	8,743,500	2,169,776	306,216	455,155	4,946,011	16,620,657

Viti 2024

Viti 2024

Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komu- nale	Subvencion e	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Z.Kryetarit	158,529	46,985		8,000		213,514
D.Administratës	237,218	130,700			5,000	372,918
D.Inspeksionit	74,322	42,415				116,737
Z.Kuvendit	110,477	14,950				125,427
D.Buxhet-Finan.	104,224	18,500				122,724
D.Sh.Publike	164,946	294,629	133,489	110,000	249,451	952,515
D.Infrastrukturë	50,006	26,138			3,688,341	3,764,485
Z.Kom.Komun.	8,036	670				8,706
D.Bujqësi,Pyllta	76,573	13,200		81,910		171,683
D.Zhv.Ekon.	49,230	29,800		27,000		106,030
D.Gj.K.Pronë	84,570	11,078			400,000	495,648
D.Urbanizem	48,277	18,417			40,000	106,694
Adm.Shëndetësi	36,746	53,340		35,000		125,086
QKMF-ja	1,310,633	462,502	81,029		444,843	2,299,007
QPS-ja	92,420	16,713	7,447			116,580
D.K,R,Sport	75,671	89,949		125,000	167,000	457,620
Adm.Arsim	77,524	295,646		100,000	70,537	543,707
Ars.Paraf-Qer.	121,182	48,482	6,500			176,164
Ars.Fillor	4,602,555	434,176	67,000		581,065	5,684,796
Ars.Mesem	1,304,079	147,743	23,000			1,474,822
R.përmbledhës	8,787,217	2,196,033	318,465	486,910	5,646,237	17,434,862
Finale	8,787,218	2,196,033	318,465	486,910	5,646,237	17,434,682



REPUBLIKA E KOSOVES

KOMUNA GLLOGOC

GLLOGOC MUNICIPALITY

Pranuar

17/08

2024

Nj. Org.

Numër

Shtjësia

Vlerësimi

01-

400-39183

KOMUNA E DRENASIT
LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2022-2024

Proq	Emri i Projektit	10 - BH/21 - THV 2022	2022	Financim Huamir	Totali 2022	V	Vlerësuar për 2023	vlerësuar për 2024	Totali 2022-2024	Financimi Jashtëm
611163 - Administrata dhe Personeli										
133										
133	Paisje për mbi 1000€					30,000.00	10,000	5,000	45,000	
				-		30,000	10,000.00	5,000	45,000	0
Totali - Administrata dhe Personeli										
				-		30,000	10,000	5,000	45,000	0
611180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia										
Infrastruktur Rugore										
451	Rregullimi dhe kultivimi i sferaveqve gjelbruse dhe rregullimi sheshit					23,000.00	23,000.00	23,000.00	69,000.00	
451	Rehabilitimi i rrugëve të asfaltura në komunën e Drenasit			0	32,100.00		38,023.00	38,951.00	109,074.00	0
451	Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve		22,500.00	0			22,500.00	22,500.00	45,000.00	0
451	Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit			0	40,000.00		40,000.00	40,000.00	120,000.00	0
451	Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike	-	40,000.00	0			40,000.00	40,000.00	80,000.00	0
451	Zgjerimi dhe mirëmbajtja kamerave në Komunën		5,000.00	0			5,000.00	5,000.00	10,000.00	0
451	Rregullimi dhe mirëmbajtja trotuarve dhe parkingjeve		10,000.00				10,000.00	10,000.00	20,000.00	
451	Instalimi i ndriqimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriqimit publik ekzistues	-	30,000.00				30,000.00	30,000.00	60,000.00	
451	Renovimi i objektit SHZSH-se në Globar				5,000.00		-	-	-	
451	Riparimi dhe zgjerimi i vendaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre		30,000.00	0			30,000.00	30,000.00	60,000.00	0
451	Bashkfinancim projektsh			0	10,000.00		10,000.00	10,000.00	30,000.00	0
	SHPMCE-Infrastruktur Rugore	-	137,500.00	0	110,100.00		248,523.00	249,451.00	608,074.00	0

Drejitoria për Infrastruktur Publike


Infrastruktur Publike										
451	Rregullimi i shiritit të lumit Drenica dhe Verbica			-	20,000.00		20,000.00	20,000.00	60,000.00	0
451	Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komun			-	350,000.00		400,000.00	400,000.00	1,150,000.00	0
451	Rregullimi i infrastrukturës trotuarëve dhe ndriqimi publik Komunën e Drenasit		100,000.00	-	100,000.00		15,000.00	14,000.00	129,000.00	
451	Ndërtimi i Infrastrukturës (Asfaltimi dhe Kubzimi)Drenas I,II,III dhe IV				200,000.00		15,000.00	14,000.00	229,000.00	
451	Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit " Fehmi dhe Xheve Liadrovci Drenas		150,000.00		70,000.00		15,000.00	14,000.00	99,000.00	
451	Infrastruktura në Komoran I,II,III dhe IV			-	100,000.00		70,000.00	79,000.00	249,000.00	0
451	Ndërtimi i lumbinave dhe Mureve Mbrojtëse			-	100,000.00		80,000.00	49,000.00	229,000.00	0
451	Rehabilitimi dhe rekonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Drenas		100,000.00	-	100,000.00		15,000.00	14,000.00	129,000.00	0
451	Rehabilitimi dhe rekonstruimi i rrjetëve të kanalizimeve në Komunën e Drenas		100,000.00	-			40,000.00	89,000.00	129,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Gllanasellë Godanc			-	40,000.00		90,000.00	80,000.00	210,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I,II dhe Globar		20,000.00	-	40,000.00		59,000.00	90,000.00	189,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Poplek i Vjeter,Poplek i Ri,Vasileve			-	50,000.00		90,000.00	90,000.00	230,000.00	0
451	Infrastruktura në fshatin Abri Epërme ,Terdevc			-	50,000.00		79,000.00	80,000.00	209,000.00	0

451	Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec Qikatovë e Vjetër			-	50,000.00	80,000.00	100,000.00	230,000.00	0
451	Asfaltimi i rruges ne fshatin Baicë,Krajkovë , Damanek Shtrubullove			-	50,000.00	80,000.00	100,000.00	230,000.00	0
451	Ndertimi Infrastruktures Nekoc Kizharekë			-	50,000.00	80,000.00	100,000.00	230,000.00	0
451	Asfaltimi i rruges Gradicë-Likoshan		30,000.00	-	20,000.00	80,000.00	100,000.00	200,000.00	0
451	Asfaltimi i rruges ne fshatin Arllat, Negroc, Gjergjice si dhe Bytyq		25,500.00	-	24,500.00	80,000.00	100,000.00	204,500.00	0
451	Asfaltimi i rruges fshatin Sankoc,Fushitc Epërme dhe Fushitc e Ulet			-	30,000.00	80,000.00	100,000.00	210,000.00	0
451	Hartimi i projekti për fizibilitetin e nxemjes qendrore			-	10,000.00	99,000.00	110,000.00	219,000.00	0
451	Asfaltimi i Rrugës në fshatin Shutic,Verboc,Polluzh		20,000.00	-	30,000.00	80,000.00	100,000.00	210,000.00	0
451	Asfaltimi rrugës në fshatin Llapushnik,Poterk,Vukovc		20,000.00	-	30,000.00	80,000.00	100,000.00	210,000.00	0
451	Asfaltimi i rrugës Zabel I Ulet,dhe Epërm,Korrotice e Ulet dhe Eperme			-	50,000.00	80,000.00	119,000.00	249,000.00	0
451	Asfaltimi i rruges ne fshatin Terdec-Vuqak			-	5,000.00	80,000.00	164,000.00	249,000.00	0
451	Ndertimi i kapacitetit te ujit në Komunën e Drenasit		42,986.00	-	157,014.00	200,000.00	200,000.00	557,014.00	0
451	Bashkëfinancim projektev me donator te jashtem			-	50,000.00	74,395.00	119,000.00	243,395.00	0
451	Mbikqaja e projekteve Kapitale ne KK Drenas			-	40,000.00	80,000.00	119,000.00	239,000.00	0
451	Hartimi i projekteve zbatuse Kapitale per nevoja e Komunës			-	58,246.00	60,000.00	119,000.00	237,246.00	0
451	Hapja e Kanaleve kulluese per gjate rrugëve ne Komun			-	10,000.00	80,000.00	119,000.00	209,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza dhe atmosferik ne Drenasin I,II,III dhe IV			-	10,000.00	71,000.00	119,000.00	200,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Komoran I,II,III dhe IV			-	10,000.00	71,000.00	119,000.00	200,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza Arllat ,Negroc Gjergjic dhe Bytyq			-	10,000.00	75,000.00	50,000.00	135,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave të zeza Sankoc,Fushitcë Epërme dhe Fushitcë e Ulet			-	10,000.00	105,000.00	50,000.00	165,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza Terstenik I dhe II dhe Gllobaë			-	10,000.00	75,373.00	50,000.00	135,373.00	0
451	Kanalizimi i ujrave të zeza Korroticë e Ulet dhe Korroticë e Epërme			-	10,000.00	73,000.00	20,000.00	103,000.00	0
451	Poklek I Vjeter dhe Ri			-	10,000.00	75,000.00	30,000.00	115,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te fshatit Dobroshec,Qikatovë e Vjetër			-	10,000.00	60,000.00	20,000.00	90,000.00	0
451	Kanalizimin e ujrave te zeza Abri e Epërme, Terdec			-	10,000.00	60,000.00	30,000.00	100,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza në fshatin Gllanasellë, Godanc			-	10,000.00	60,000.00	30,000.00	100,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza Gradicë,Likoshan			-	10,000.00	50,000.00	20,817.00	80,817.00	0
451	Kanalizimi i Ujrave te zeza ne fshatin Llapushnik,Poterk dhe Vukovc			-	10,000.00	50,000.00	50,000.00	110,000.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza ne fshatin Nekoc ,Kishanarekë			-	6,882.00	50,000.00	50,000.00	106,882.00	0
451	Kanalizimi i ujrave të zeza Shutic Verboc dhe Polluzhë			-	10,000.00	50,000.00	58,524.00	118,524.00	0
451	Kanalizimi i ujrave te zeza Baicë ,Krajkovë dhe Damanek, Shtrubullo			-	0	2,021,642.00	3,317,768.00	3,688,341.00	9,027,751.00
451	Kanalizimi i ujrave te zeza Baicë ,Krajkovë dhe Damanek, Shtrubullo			-	0	2,021,642.00	3,317,768.00	3,688,341.00	9,027,751.00
Totali - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia-Infrastrukt PUBLIKE									
611650 - Kadastra dhe Gjeodezia									
Sherbime Kadastrale									
610	Shpronsimi			-	400,000.00	400,000.00	400,000.00	1,200,000.00	0
	Totali - Kadastra dhe Gjeodezia			-	400,000.00	400,000.00	400,000.00	1,200,000.00	0
611660 - Planifikimi Urban dhe Mjedisi									
Planifikim Urban dhe Inspektion									
620	Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme		15,000.00	-		15,000.00	15,000.00	30,000.00	0
620	Mirëmbajtja e sistemit të adresave vendosja e tabelave dhe numrave ne teren		5,000.00	-		5,000.00	5,000.00		0
620	Gjelbrimi i hapsirave publike		20,000.00	-		20,000.00	20,000.00	40,000.00	0
	Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi			-		40,000.00	40,000.00	80,000.00	0

Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi				40,000.00	-	40,000.00	40,000.00	80,000.00	0
611730 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale									
Sherbime shëndetësore primare									
721	Paisje speciale mjeksore mbi 1000€					182,855.00	348,726.00	444,843.00	976,424.00
721	Vetura të ndihmës shpejtë dy copa me paisje					140,000.00			-
Totali - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale						322,855.00	348,726.00	444,843.00	976,424.00
611850 - Kulturë, Rini, Sport									
Sherbimet Kulturore									
820	Renovimi i objekteve sportive			20,000.00	-		20,000.00	20,000.00	40,000.00
820	Ndërtimi i stadionit faza e dytë				-	100,000.00	75,000.00	70,000.00	245,000.00
820	Inventarizimi i arkivit dhe Qndres së Kulturës			10,000.00			10,000.00	10,000.00	20,000.00
820	Fusha Sportive dhe rekracion			115,000.00	-		67,000.00	67,000.00	134,000.00
Totali - Kulturë, Rini, Sport				145,000.00	-	100,000.00	172,000.00	167,000.00	439,000.00
611920 - Arsime dhe Shkencë									
Administrat-Glllogoc									
980	Digitalizimi i Institucioneve arsimore ne Drenas					80,000.00	62,000.00	95,000.00	237,000.00
980	Inventarizimi i shkollave ne Drenas				-	40,000.00	80,000.00	90,000.00	210,000.00
980	Furnizimi i shkollave me paisje të TIK-ut				-	70,000.00	50,000.00	100,000.00	220,000.00
980	Furnizimi i shkollave me kabinete për kimi, fizikë biologji			50,000.00	-		50,000.00	111,602.00	161,602.00
980	Ndërtimi i depove për lëndë djegëse			25,000.00					
980	Ndërtimi i fushave të jashtme sportive dhe rrethoia			45,000.00					
980	Renovimi i shkollave objekteve shkollore ,nyje sanitare dhe ngjyrosje dhe suvatim			82,000.00	-		100,000.00	45,000.00	101,994.00
980	Riparimi i nxemjeve qendrore			10,000.00	-		10,000.00	150,000.00	160,000.00
Totali - Arsime dhe Shkencë				212,000.00	-	190,000.00	408,994.00	651,602.00	1,250,596.00
Totali				1,152,986.00		3,174,597.00	4,946,911.00	5,646,237.00	15,411,406.00

Glllogoc, me 17.08.2021.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere /
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Zyra e Ministrisë / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister


DATE/A:	05.08.2021
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2022/02 për Komuna

Të nderuar,

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2022/02 për Komuna, e cila ofron kufijtë buxhetor për secilën komunë për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të buxheteve komunale për vitin 2022.

Me respekt!


Hekuran Murati
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



Qarkorja Buxhetore 2022/02

1. Qëllimi

Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë Qarkore Buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Dytë Buxhetore 2022/02, ku ofrohen udhëzimet për hartimin e buxhetit për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 si dhe jepen kufijtë buxhetor final. Këta kufij mund të ndryshojnë varësisht rishikimit të KASH 2022-2024.

2. Kriteret e përgjithshme dhe specifike për përgatitjen e buxhetit

Komunat duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së projektbuxhetit t'i japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve komunale;
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale;
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon komiza e tyre buxhetore;
- Për të respektuar rregullin fiskal të pagave të paraparë me legjislacionin e financave publike në Kosovë dhe për të liruar presionin mbi buxhetin komunal për paga dhe shtesa, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kërkon nga komunat që të fshijnë numrin e pozitave fiktive (pozita pa mbulesë buxhetore). Numri aktual i të punësuarve (duke përfshirë të punësuarit me pushim pa pagesë dhe të punësuarit që janë në pushim të lehonisë) dhe numri i pozitave që janë në procedurë të rekrutimit duhet të mbesin. Në lidhje me këtë ju lutemi që deri më datë 15 gusht 2021 të dërgoni informatat e punësimit.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2022 dhe projeksionet për vitet 2023-2024 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira buxhetore me fokus në këto çështje:
 - Plotësimin e të dhënave që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe eliminimin e keqklasifikimit të shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga Komunat analisti buxhetor do të identifikojë keqklasifikime, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largoj nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keqklasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
 - Projektet e propozuara të jenë projekte të përgatitura në përputhje me Manualin e PIP-it dhe Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale;
 - Projektet e propozuara të jenë të maturuara (projekte të gatshme për zbatim);

- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
- Buxhetimi i projekteve kapitale duhet të bëhet në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Me këtë rast, komunat pas një analize paraprake duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.

Në vijim të këtij procesi vëmendje e shtuar nga MFPT do t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të lartpërmendura. Nëse komunat nuk plotësojnë të dhënat sipas manualit të PIP dhe analizën për çdo projekt-propozim të ri sipas UA për Kriteret Përzgjedhëse si dhe nëse dorëzohet propozim buxheti që përmban keqklasifikim, atëherë MFPT do të marrë masa për korrigjimin e tyre para dorëzimit të projektbuxhetit për vitin 2022 për aprovim në Qeveri.

3. Kufijtë buxhetor për komunat (struktura e shpenzimeve)

Komunat duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelat në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2022 dhe për dy vitet në vijim.

Ju lutem të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga rishikimi i KASH 2022-2024.

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitet 2022-2024 secila komunë duhet të respektoj strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të lëshuara me këtë qarkore.

Struktura është përgatitur duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2022/01 (politikat e reja dhe në vazhdimësi të aprovuara nga Komisioni i Granteve) si dhe KAB komunal për vitin 2022-2024.

Më poshtë në Tabelat e bashkangjitura është paraqitur struktura e shpenzimeve për vitin 2022-2024.

4. Dorëzimi i propozim-buxhetit komunal

Pas aprovimit të propozim-buxhetit për vitin 2022-2024 nga Kuvendet Komunale, komunat duhet të dorëzojnë atë në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve deri me datë **30 shtator 2021**. Propozim buxheti i aprovuar duhet të përmbajë dokumentet si në vijim:

- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal.
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal 2022-2024,
- Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve 2022-2024,
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2022-2024,
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal 2022-2024,
 - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjninor,
 - Tabelat e Buxhetimit sipas performancës.

Tabela 1: Struktura e shpenzimeve për vitin 2022

Nr.	Komunat	Nr. i të punësuarve	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej 2022
1	Deçan	880	5,698,340	1,694,536	156,000	160,000	2,940,479	10,649,355
2	Dragash	776	4,830,821	1,063,000	130,000	270,000	3,035,656	9,329,477
3	Ferizaj	2,407	15,960,525	5,529,067	725,686	963,776	10,754,814	33,933,868
4	Fushë Kosovë	776	5,290,000	1,900,000	260,000	455,000	3,751,080	11,656,080
5	Gjakovë	2,252	14,430,000	3,564,341	578,700	600,500	8,643,390	27,816,931
6	Gjilan	2,479	16,199,142	4,727,835	576,800	970,000	6,601,502	29,075,278
7	Glogoc	1,327	8,700,000	2,100,000	298,508	420,000	4,327,583	15,846,091
8	Hani i Elezit	239	1,756,083	385,975	67,700	80,000	470,000	2,759,758
9	Istog	974	6,511,000	1,593,959	202,000	310,000	2,995,040	11,611,999
10	Junik	163	1,154,611	202,780	36,200	50,000	215,000	1,658,591
11	Kaçanik	804	5,289,744	909,423	221,000	300,000	2,473,001	9,193,168
12	Kamenicë	1,189	7,542,413	1,619,200	211,800	343,000	1,354,178	11,070,591
13	Klinë	950	6,460,889	1,308,064	167,000	350,000	3,047,380	11,333,332
14	Leposaviq	569	2,363,643	415,316	64,000	95,000	1,664,956	4,602,915
15	Lipjan	1,526	9,886,000	1,998,000	330,000	766,000	4,613,652	17,593,652
16	Malishevë	1,299	8,591,643	1,729,730	455,000	500,000	4,379,384	15,655,757
17	Mamushë	155	1,160,695	327,000	31,000	40,000	243,345	1,802,040
18	Mitrovicë	1,989	12,482,357	3,330,842	488,008	636,500	4,589,006	21,526,713
19	Novobërdë	351	2,122,675	312,594	70,000	52,900	354,511	2,912,680
20	Obiliq	647	4,350,000	1,288,679	316,675	850,000	5,016,815	11,822,169
21	Pejë	2,250	14,887,342	3,700,000	748,455	531,016	9,429,241	29,296,054
22	Podujevë	1,995	12,470,000	2,650,000	420,000	960,000	6,949,521	23,449,521
23	Prishtinë	4,755	31,300,000	21,198,930	2,200,000	4,786,215	31,184,188	90,669,333
24	Prizren	3,175	21,350,000	8,650,550	1,071,199	1,880,000	16,504,006	49,455,755
25	Rahovec	1,186	7,872,844	1,735,000	270,000	360,000	4,815,816	15,053,660
26	Shtërpçë	517	2,490,000	469,917	82,625	45,000	783,806	3,871,348
27	Shtime	665	4,405,585	1,000,704	210,000	150,000	1,937,740	7,704,029
28	Skenderaj	1,338	8,350,000	1,700,000	200,000	730,000	3,548,788	14,528,788
29	Suharekë	1,316	8,611,766	2,450,000	386,000	490,000	5,182,865	17,120,631
30	Viti	1,161	7,618,305	2,092,704	320,000	360,000	2,678,486	13,069,495
31	Vushtrri	1,601	10,720,000	3,278,239	428,000	657,540	4,779,107	19,862,886
32	Zubin Potok	421	1,530,000	291,000	50,000	91,104	570,901	2,533,005
33	Zveçan	368	1,490,000	305,060	40,000	80,000	400,128	2,315,188
34	Gracanicë	591	3,110,760	1,497,590	182,000	230,859	2,520,811	7,542,020
35	Kilokot	123	780,000	150,000	60,000	10,000	145,364	1,145,364
36	Mitrovicë veriore	857	2,920,000	446,799	46,000	185,000	1,765,185	5,362,984
37	Partesh	144	895,000	150,000	40,000	10,000	34,456	1,129,456
38	Ranilug	189	1,125,600	210,000	45,000	70,000	118,821	1,569,421
Gjithsej		44,404	282,707,782	87,976,834	12,185,356	19,839,410	164,820,000	567,529,382

Tabela 2: Struktura e shpenzimeve për vitin 2023

Nr.	Komunat	Paga dhe shtesa	Malra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej 2023
1	Deçan	5,726,832	1,750,840	160,028	173,392	3,440,584	11,251,676
2	Dragash	4,854,975	1,098,320	133,357	292,599	3,409,871	9,789,123
3	Ferizaj	16,040,327	5,712,779	744,424	1,044,446	12,277,640	35,819,615
4	Fushë Kosovë	5,316,450	1,963,130	266,714	493,084	4,137,105	12,176,483
5	Gjakovë	14,502,150	3,682,772	593,643	650,763	9,791,873	29,221,200
6	Gjilan	16,280,137	4,884,925	591,694	1,051,191	7,947,876	30,755,822
7	Glogoc	8,743,500	2,169,776	306,216	455,155	4,946,011	16,620,657
8	Hani i Elezit	1,764,863	398,800	69,448	86,696	584,048	2,903,855
9	Istog	6,543,555	1,646,921	207,216	335,947	3,446,871	12,180,510
10	Junik	1,160,384	209,518	37,135	54,185	272,268	1,733,490
11	Kaçanik	5,316,193	939,640	226,707	325,110	2,844,485	9,652,135
12	Kamenicë	7,580,125	1,673,000	217,269	371,710	1,780,098	11,622,202
13	Klinë	6,493,193	1,351,526	171,312	379,296	3,676,638	12,071,965
14	Leposaviq	2,375,461	429,116	65,653	102,952	1,838,324	4,811,505
15	Lipjan	9,935,430	2,064,387	338,521	830,115	5,249,442	18,417,896
16	Malishevë	8,634,601	1,787,203	466,749	541,851	5,210,354	16,640,758
17	Mamushë	1,166,498	337,865	31,800	43,348	302,441	1,881,953
18	Mitrovicë	12,544,769	3,441,514	500,609	689,776	5,391,880	22,568,549
19	Novobërdë	2,133,288	322,980	71,808	57,328	464,119	3,049,523
20	Obiliq	4,371,750	1,331,497	324,852	921,146	5,202,280	12,151,525
21	Pejë	14,961,779	3,822,938	767,781	575,463	10,662,725	30,790,686
22	Podujevë	12,532,350	2,738,050	430,845	1,040,354	8,047,162	24,788,761
23	Prishtinë	31,456,500	21,903,297	2,256,807	5,186,829	33,974,817	94,778,250
24	Prizren	21,456,750	8,937,978	1,098,859	2,037,359	18,334,127	51,865,073
25	Rahovec	7,912,208	1,792,648	276,972	390,133	5,441,320	15,813,281
26	Shtërpçë	2,502,450	485,531	84,759	48,767	926,584	4,048,090
27	Shtime	4,427,613	1,033,954	215,423	162,555	2,250,222	8,089,766
28	Skenderaj	8,391,750	1,756,485	205,164	791,102	4,075,510	15,220,012
29	Suharekë	8,654,825	2,531,405	395,967	531,014	5,865,276	17,978,486
30	Viti	7,656,397	2,162,237	328,263	390,133	3,184,248	13,721,277
31	Vushitri	10,773,600	3,387,164	439,052	712,577	5,501,495	20,813,887
32	Zubin Potok	1,537,650	300,669	51,291	98,730	656,788	2,645,128
33	Zveçan	1,497,450	315,196	41,033	86,696	476,663	2,417,038
34	Gracanicë	3,126,314	1,547,350	186,700	250,182	2,713,697	7,824,242
35	Kilokot	783,900	154,984	61,549	10,837	186,708	1,197,978
36	Mitrovicë veriore	2,934,600	461,645	47,188	200,485	1,919,909	5,563,827
37	Partesh	899,475	154,984	41,033	10,837	72,785	1,179,114
38	Ranillug	1,131,228	216,978	46,162	75,859	171,111	1,641,338
Gjithsej		284,121,321	90,900,000	12,500,000	21,500,000	186,675,356	595,696,677

Tabela 3: Struktura e shpenzimeve për vitin 2024

Nr.	Komunat	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej 2024
1	Deçan	5,755,466	1,772,027	166,429	185,489	3,914,413	11,793,824
2	Dragash	4,879,250	1,111,611	138,691	313,013	3,824,604	10,267,169
3	Ferizaj	16,120,529	5,781,910	774,201	1,117,314	13,760,121	37,554,075
4	Fushë Kosovë	5,343,032	1,986,887	277,382	527,485	4,613,853	12,748,639
5	Gjakovë	14,574,661	3,727,338	617,389	696,165	11,216,786	30,832,338
6	Gjilan	16,361,538	4,944,038	615,362	1,124,529	9,197,064	32,242,531
7	Glogoc	8,787,218	2,196,033	318,465	486,910	5,646,237	17,434,862
8	Hani i Elezit	1,773,688	403,626	72,226	92,745	697,114	3,039,398
9	Istog	6,576,273	1,666,850	215,505	359,386	3,949,065	12,767,078
10	Junik	1,166,186	212,053	38,620	57,965	337,245	1,812,070
11	Kaçanik	5,342,774	951,011	235,775	347,793	3,245,128	10,122,480
12	Kamenicë	7,618,026	1,693,246	225,960	397,643	2,249,992	12,184,866
13	Klinë	6,525,659	1,367,882	178,165	405,758	4,173,052	12,650,516
14	Leposaviq	2,387,339	434,308	68,279	110,134	2,040,796	5,040,855
15	Lipjan	9,985,107	2,089,368	352,062	888,030	5,996,502	19,311,070
16	Malishevë	8,677,774	1,808,830	485,419	579,654	5,896,728	17,448,406
17	Mamushë	1,172,331	341,954	33,072	46,372	374,290	1,968,019
18	Mitrovicë	12,607,493	3,483,161	520,633	737,900	6,489,221	23,838,408
19	Novobërdë	2,143,955	326,889	74,680	61,327	577,093	3,183,944
20	Obiliq	4,393,609	1,347,610	337,846	985,412	5,430,104	12,494,581
21	Pejë	15,036,588	3,869,200	798,492	615,611	12,151,286	32,471,177
22	Podujevë	12,595,012	2,771,184	448,079	1,112,936	9,062,589	25,989,800
23	Prishtinë	31,613,783	22,168,354	2,347,080	5,548,701	37,477,643	99,155,560
24	Prizren	21,564,034	9,046,138	1,142,813	2,179,500	20,414,992	54,347,478
25	Rahovec	7,951,769	1,814,341	288,051	417,351	6,296,418	16,767,931
26	Shtërpçë	2,514,962	491,406	88,149	52,169	1,070,366	4,217,052
27	Shtime	4,449,751	1,046,466	224,039	173,896	2,579,558	8,473,711
28	Skenderaj	8,433,709	1,777,741	213,371	846,295	4,671,353	15,942,469
29	Suharekë	8,698,099	2,562,038	411,806	568,061	6,616,379	18,856,383
30	Viti	7,694,679	2,188,403	341,393	417,351	3,751,332	14,393,158
31	Vushtrri	10,827,468	3,428,152	456,614	762,292	6,343,389	21,817,914
32	Zubin Potok	1,545,338	304,307	53,343	105,618	759,679	2,768,285
33	Zveçan	1,504,937	319,010	42,674	92,745	569,598	2,528,964
34	Gracanica	3,141,945	1,566,075	194,167	267,637	2,948,996	8,118,820
35	Klllokot	787,820	156,859	64,011	11,593	229,156	1,249,439
36	Mitrovicë veriore	2,949,273	467,231	49,075	214,472	2,282,122	5,962,173
37	Partesh	903,972	156,859	42,674	11,593	115,544	1,230,643
38	Ranillug	1,136,884	219,603	48,008	81,152	229,429	1,715,076
Gjithsej		285,541,928	92,000,000	13,000,000	23,000,000	211,199,236	624,741,163